

Zhvillohet në Moskë Kongresin i XXIII-të i NTOSAI-t

Nga data 23-27 shtator 2019 u zhvillua në Moskë Kongresi i XXIII-të i Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Në kongres morën pjesë 600 delegatë nga 168 SAI nga 192 anëtarë, përfaqësues të të gjitha organizatave rajonale të INTOSAI-t.



Kongresi i XXIII-të i INTOSAI-t trajtoi dy tema kryesore :

I. Teknologjia e Informacionit dhe roli i saj në zhvillimin e administratës publike

Në temën e I-rë u diskutuan shumë çështje të rëndësishme që lidhen me zhvillimet IT sepse në vitet e fundit këto zhvillime kanë ndikuar në mënyrë sinjifikative në jetën e qytetarëve në mbarë botën. Revolucioni teknologjik, në veçanti telefonia celulare, big data dhe intelijenca artificiale janë në zhvillim të vazhdueshëm. Në këtë proces, zhvillet e reja teknologjike kanë sjellë rritje eksponenciale të të dhënave në forma të ndryshme, duke krijuar mundësinë që marrja e vendimeve publike të jetë më racionale dhe më efiçente. Nga diskutantët e ndryshëm gjatë zhvillimit të seancave plenare lidhur me këtë temë u trajtuan tematikat si më poshtë :

- Roli i IT në Administratën Publike;
- Përdorimi i të dhënave për përmirësimin e administratës publike;
- Karakteristikat e Big Data;
- Roli i Big Data në përmbushjen e detyrave nga SAI-t;
- Sfidat që duhet të përballen nga Auditimi i Big Data.

II. Roli i SAI-ve në Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm

Në këtë seancë plenare diskutimi më i rëndësishëm ishte ai i z. Gene Dodaro, Kontrollor i Përgjithshëm i Zyrës së Auditimit të Qeverisë së SHBA. Zoti Dodaro nënvizoi lidhjen mes 17

Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara dhe Planit të Zhvillimit Strategjik të GAO-s, të cilat i referohen gjithashtu çështjeve vitale dhe relevante në SHBA.

Nëse i referohemi Programit të Riskut të Lartë, duke filluar që nga viti 1990, ky program është fokusuar në operacionet e qeverisë me risk më të lartë për mashtrime, vjedhje, abuzime, keqmenaxhim dhe kjo me qëllim që të përballojmë sfidat me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet.

SAI-t duke adoptuar një qasje të plotë qeverisëse në auditimet e tyre mund të kontribuojnë në arritjen e prioriteteve dhe objektivave kombëtare, duke sjellë vlera dhe përfitime për palët e interesit dhe për qytetarët.

Në përfundim të këtij aktiviteti të rëndësishëm u vendos që Kongresi i ardhshëm i INTOSAI-t, INCOSAI XXIV të zhvillohet në Brazil.

Në këtë aktivitet të rëndësishëm, KLSH u përfaqësua nga zj. Luljeta Nano, Sekretare e Përgjithshme; zj. Manjola Naço, Drejtore e Përgjithshme dhe zj. Irena Islami, Drejtore e Drejtorisë së Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë.